



---

**VENDIM**

**Nr. 48, Datë 31.03.2017**

**MBI**

**LICENSIMIN E SHOQËRISË “GRID ENERGY” SH.P.K, NË  
AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, nenit 37, pika 2, gërma “ç” dhe 39 pika 3, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neni 4, pika 1, gërma “d”; neni 5, pika 1, gërma “d”, neni 13; të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 19 pika 1 të “Rregullores së Organizimit funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 31.03.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licensimin e shoqërisë “Grid Energy” sh.p.k, në aktivitetin e furnizimit të Energjisë Elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut;

**Konstatohet se:**

Bordi i ERE-s, me Vendimin Nr. 39, datë 06.03.2017, vendosi: ”Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për licensim të shoqërisë “Grid Energy” sh.p.k, në aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike“.

Aplikimi i shoqërisë “Grid Energy” sh.p.k, plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat ( “a”, “b”, “c”, “d”, “e”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b” “c”, “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7.1, gërmat “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

**Vendosi:**

1. Të licensojë shoqërinë “Grid Energy” sh.p.k, në aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5 (pesë) - vjeçar.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**

**Petrit AHMETI**

